



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01-2259/21
Kaçanik, 29.01.2021

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 40.2 (d) të ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Janar 2021 mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME
PUBLIKE, PËR VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike, për vitin 2021, i propozuar nga Komiteti për Shërbime Publike i Kuvendit të Komunës.
2. Në Planin e Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021, janë paraqitur, objektivat e këtij Komiteti, numri i mbledhjeve dhe periudhat e mbajtjes së mbledhjeve.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike, i përmbledhur në gjithsej, 2 faqe, Lënda : 01 Nr. 60/01-2256/21.
4. Për zbatimin e Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike do të kujdeset: Komiteti për Shërbime Publike dhe organet tjera relevante të komunës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Komiteti për Shërbime Publike, Kryetari i Komunës, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

I	Data	12.01.2021	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	60/d-2259	-/-		

Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021

Janar, 2021

HYRJA

Kuvendi Komunal në mbështetje të dispozitave të nenit 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale dhe nenit 31 dhe 32.1, 32.2, 32.3 të Statutit të Komunës së Kaçanikut dhe në bazë të mandatit të dhënë nga Kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale, në mbledhjen e vet të mbajtur në muajin Maj të vitit 2018, mori vendim për themelimin e Komitetit për Shërbime Publike.

Në bazë të udhëzimit administrative Nr.02\2018 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrative Nr.03\2014 për procedurën e themelimit , përbërjen dhe kompetencat Komiteteve të përherëshme në Komunë, Kuvendi I komunës, varësisht nga nevoja e përgjegjësisve në sektor të caktuar mund të themeloj komitete të tjera.

Komitete tjera, siç është edhe Komiteti për Shërbime Publike përbëhen nga 5 anëtarë, dhe atë anëtarët e Kuvendit dhe përfaqësuesit jashtë Kuvendit të komunës.

Kalendari i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021

Takimet	Periudhe kohore e takimeve	Vendi i takimit	Aktivitetet dhe qështjet për t'u diskutuar	Kryesuesi i takimit
Takimi I	Pjesa e parë e muajit shkurt	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Shqyrtimi I raportit vlerësues rreth performancës së Komunës - Shqyrtimi dhe miratimi I raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike të vitit 2020 - Informatë rreth sektorit të emergjencave të Komunës - Raporti rreth gjendjes së mirëmbajtjes së rrugëve gjatë sezonit dimërorë	Kryesuesi KSHP
Takimi II	Pjesa e parë e muajit mars	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Informatë mbi raportin e punës së KRU "Bifurkacioni" njësia në Kaçanik - Informatë mbi raportin e punës KRM "Pastërtia" njësia në Kaçanik - Informatë rreth mbrojtjes së mjedisit në Komunë	Kryesuesi KSHP
Takimi III	Pjesa e parë e muajit prill	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Informatë rreth menagjimit të hapësirave publike - Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm - Shqyrtimi I marrëveshjes për financimin e shërbimeve të varrimit	Kryesuesi KSHP
Takimi IV	Pjesa e parë e muajit maj	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Raporti I punës së Inspektoratit të mjedisit - Informatë rreth gjendjes dhe mirëmbajtjes verore të rrugëve në Komunë - Takim publik me qytetarë	Kryesuesi KSHP
Takimi V	Pjesa e parë e muajit qershor	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Informatë mbi raportin e vlerësimit të performancës së Komunës - Informatë rreth funksionimit të sistemit të kanalizimit dhe ujërave atmosferikë - Informatë rreth ndriçimit publik	Kryesuesi KSHP
Takimi VI	Pjesa e parë e muajit gusht	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Informatë rreth përgaditjes për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror - Hartimi I planit të punës së KSHP-së	Kryesuesi KSHP

Kryesuesi i KSHP

Kaçanik 2021

